

16456



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT
TIRANE

NR.

**VENDIM
PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK**

Sot me daten 10.12.1996 une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane si shqyrtove kerkesen e kerkuesit Eli Kanani e cila kerkon te rregjistrohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "KANANI sh.p.k.si person juridik ortak i vetem;

K O N S T A T O V A

Kerkuesja kerkon rregjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "KANANI" sh.p.k. me ortak dhe administrator te vetem Eli Kanani me seli ne Tirane rruga Arkitekt Kasemi nr. 173, me kapital fillestar 100.000 leke dhe kohezgjatje 10 vjet dhe me objekt veprimtarie ne fushen e tregtimit me shumice dhe pakice te produkteve farmaceutike humane dhe veterinare, ne fushen e import-eksport, te tregtimit te pajisjeve farmaceutike etj.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille ajo duhet te pranohet.

PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit nr.7638 date 10.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar"

V E N D O S A :

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "KANANI" sh.p.k. me ortak dhe administrator te vetem Eli Kanani me seli ne Tirane, me kapital fillestar 100.000 leke, me kohezgjatje mbi 10 vjet dhe me objekt veprimtarie ne fushen e import eksportit, tregtimit me shumice dhe pakice te produkteve farmaceutike humane dhe veterinare, tregtimin e pajisjeve farmaceutike etj.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne shkalle te dyte.

GJYQTARE

Oristo Gjyqtare
Alba

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR.

16456/1

V E N D I M
I
GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me daten 31/01.2007, une gjyqtarja Q. Mj e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, mbasi mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentet e paraqitura nga kerkuesi Znj. Eli KANANI ,

K O N S T A T O V A S E :

Shoqeria "KANANI" Shpk eshte regjistruar si person juridik me vendim te gjykates se Rrethit Tirane Nr. 16456, date 10.12.1996, me kapital 100.000 leke me ortak te vetem dhe administrator Znj. Eli KANANI, me kohe zgjatje mbi 10 vjet me objekt ne fushen e - **Import-eksportit, tregtimit me shumice e pakice, te produkteve farmaceutike humane dhe veterinare, tregtimin e pajisjeve farmaceutike.**

Me vendimin Nr.1, date 23/01/.2007 te Ortakut te Vetem te shoqerise "KANANI" shpk, Ortaku i vetem vendosi shtese te objektit te veprimtarise: "**Tregtimin e aparaturave elektromjekesore**", dhe shtese kohezgjatjes se aktivitetit "**me kohe te pakufizuar mbi 10 vjet**".

Kerkuesja kerkon qe ndryshimet e sipërpermendura te depozitohet prane Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Meqenese kerkesa dhe aktet e tjera jane te bazuara ne ligj e si te tilla duhen pranuar.

P E R K E T O A R S Y E

Konform ligjit 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin Tregtar" dhe ligjit 7638, date 19.11.1992, "Per Shoqerite Tregtare"

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses per depozitim e vendimit nr, 1, date 23.01.2007 te Ortakut te Vetem te Shoqerise "KANANI" Shpk, Znj. Eli KANANI, per shtese te objektit te veprimtarise : "**Tregtimin e aparaturave elektromjekesore**", dhe shtese kohezgjatjes se aktivitetit "**Me kohe te pakufizuar mbi 10 vjet**".

Shoqeria nuk ben ndryshime te tjera .

Te behen shenimet perkatese ne Regjistrin. Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Tirane, 31/1/ 2007

GJYQTARE

Q. Mj
Q. Mj

U. a. Oher registru.

No. Cur 1.

16456

Do. "Korona", Ser PK

6. "Korona" Pr. "Korona", Nr. 173

9. Import - export, Arhiv (nu),
Suma. Ob. Pakice te Prodektov,
farmaceutico. etc. Sigas Statuti

2. 100.000 lei Valoarea de 3.12.1996
Depoz. Bancii Kurvepene - Viper.

37 din. El. Korona Nr. 1037. Suma de pe

"Korona"

Statuti. esite. nenselizar de 5.12.1996
Statuti de 4. p. t.

Stata. 10.12.1996.



A K T - T H E M E L I M I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ KANANI” SHPK

Themelues i Shoqerise “ KANANI” sh.p.k. eshte:
Znj. Eli KANANI e bija e Kostaqit dhe e Ollges e datelindjes 1937, banues ne
Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar

Neni 1

Ortaku i vetem do te krijojte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar do ta quaje
“KANANI” sh.p.k.

Neni 2

Selia e shoqerise do te jete ne rrugen Arkitekt Kasemi nr.173/37 Tirane
Me vendim te ortakut te vetem mund te hapet seli sekondare, filiale apo forma te
tjera te shoqerise sikurse do ta shikojte te nevojshme shoqeria brenda dhe jashte
Shqiperise

Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet me te
drejten e shkrirjes para kohe.

Neni 4

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj:

Tregtimin me shumice dhe pakice te produkteve farmaceutike
Eksport - import ne fushen farmaceutike
Tregtimin e pajisjeve farmaceutike.

Neni 5

Kapitali themelor i shoqerise do te jete 100.000 (njqindmije leke) te derdhura
teresisht.

Neni 6


Kapitali themeltar eshte depozituar prej ortakut ne njeren prej bankave te Shqiperise me nje llogari te hapur ne emer te shoqerise ne formim e siper.

Neni 7

Shoqeria do te rregullohet pervec kesaj kontrate themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj i cili do te nenshkruhet nga ortaku dhe si i tille do te miratohet ne Gjykatën e rrethit Tirane, ne ditën kur do te legalizohet si person juridik ne Shqiperi.

ORTAKU I VETEM

Eli KANANI



The image shows a handwritten signature in cursive script, which appears to read "Eli Kanani". The signature is written over a rectangular stamp. The stamp contains some illegible text and a date, possibly "18". The signature is written in dark ink on a light-colored paper.

STATUT

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "KANANI" ortak i vetem

FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA

Neni 1

Shoqeria Private "KANANI" sh.p.k. me poshte e quajtur Shoqeri formohet nga ortakut i meposhtem si themelues :

Znj. Eli Kanani e bija e Kostaqit dhe e Ollges e datelindjes banuese ne Tirane rruga Arkitekt Kasem nr. 173, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Neni 2

Shoqeria formohet sipas legjislacionit shqiptar dhe si person juridik shqiptar e fillon aktivitetin me rregjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar.

Neni 3

Shoqeria e ka seline e saj ne Tirane rruga Arkitekt Kasemi nr. 173.
Me vendim te ortakut te vetem mund te hapen seli sekondare, filiale apo forma te tjera shoqerie sikurse do ta shikoj te nevojshme e te aresyeshme Shoqeria brenda dhe jashte vendit.

Neni 4

Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me statutin e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte tij.
Shoqeria mund te krijojte filiale brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise ne perputhje me legjislacionin e vendit perkates.

LIBRI I SHOQERISE

Neni 5

Per te saktësuar veprimtarine e vet ekonomike si dhe marredheniet e punes shoqeria do te cele Librin e vet i cili do te quhet Libri i Shoqerise.

KONFIDENCIALITETI

Neni 6

Ortaku qofte per vete dhe per personat e pranuar ne Shoqeri bie dakort te mos i ekspozoje asnje personi te jashtem informacionet qe disponon shoqeria, kontratat qe do te lidhin si dhe planet ose qellimet qe ajo ka per te ardhmen e saj.

Neni 7

Te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxirren nga shoqeria dhe te destinuara per te tretet si letrat, faturat, lajmerimet dhe publikimet e ndryshme etj, duhet te tregojne lexueshem emrin e shoqerise dhe pas tij fjalet “ shoqeri me pergjegjesi te kufizuar” ose iniciallet “SHPK” kapitali themeltar dhe emrin e administratorit.

OBJEKTI

Neni 8

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

- Tregtimi me shumice dhe pakice dhe eksport - import i produkteve farmaceutike .
- Tregtimi i pajisjeve farmaceutike
- Investime dhe pjesmarrje ne investime me shoqeri te tjera
- Si dhe cdo lloj veprimtarie tjeter qe do te shikohet me interes nga shoqeria

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 9

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet, duke filluar nga data e rregjistrimit ne rregjistrin tregtar

KAPITALI THEMELTAR

Neni 10

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke. Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortakut i vetem. Shoqeria mund ta shtojte apo pakesoje kapitalin e saj me miratimin e ortakut te saj te vetem.

LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

Neni 11

Pjese e kapitalit themeltar u transferohen te treteve vetem me miratim te ortakut te vetem qe perfaqeson 100% te kapitalit themeltar dhe me kushte te favorshme. Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ndermjet bashkeshorteve ne rast ndarjeje pasurore si dhe ne rruge trashegimie. Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt noterial

STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 12

Shoqeria do ta konsideroje qendren e vet si Shoqeria meme e cila rast pas rasti do te hapet me ane filialesh ose shoqerish te perbashketa ne te gjitha ato vende ku do te shikoje interes ne territorin e Shqiperise ose jashte saj.

Neni 13

Organi me i larte i drejtimit te Shoqerise eshte Asambleja e cila mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme sipas ligjit. Asambleja thirret ne mbledhjene e saj ne te gjitha rastet qe Administratori e gjen te nevojshme.

Mbledhja e Asamblese mund te kerkohet dhe nga Ortaku i vetem i shoqerise ose nga administratori i saj.

Pjesemarresit ne mbledhje lajmerohen me leter rekomande te pakten 15 (pesembedhjete) dite perpara mbledhjes se Asamblese . Ne lajmerim njoftohet rendi i dites, pershkrimi i vendit, dites dhe ores se mbledhjes.

Asambleja pas konsultimit ndermjet pjesemarresve te cilet aprovojne rendin e dites e miratojne me shkrim ate.

Vendimet ne Asamble merren nga Ortaku i vetem qe perfaqeson 100% te kapitalit themeltar me perjashtim te rasteve qe kerkojne votimin unanim te pjesemarresve ne mbledhje.

Vendimet e asamblese duhet te mbahen ne nje proces verbal i cili duhet te nenshkruhet dhe, ne rastin e nje Asambleje te Jashtezakonshme te behet ne prani te nje Noteri.

ADMINISTRATORI

Neni 14

Shoqeria perfaqesohet nga Administratori i vetem i cili eshte Ortaku i vetem Znj. Eli Kanani.

LIBRAT E SHOQERISE BILANCI SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 15

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel ose librave te tjere edhe LIBRIN E SHOQERISE ne te cilin shenohet kapitali themeltar si dhe vendimet e Asamblese se zakonshme dhe te jashtezakonshme.

Neni 16

Shoqeria mund te shperbehet perpara afatit per aresye te parashikuara ne ligj si dhe kur veprimtaria konsiderohet nga Ortaku i vetem si e padiskutueshme.

T H E M E L U E S I

Eli KANANI

Eli Kanani
Eli

SHOQERIA "KANANI"

Ortak i vetem



16456

rregjistrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar si person juridik

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Une, Eli Kanani, themeluesja e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar si ortak i vetem, ne baze te Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare"

Shoqeria "KANANI" do te kete per objekt te veprimtarise tregtimin e prodhimeve farmaceutike me pakice dhe shumice, import-eksport si dhe tregetim pajisjesh farmaceutike.


Ne baze te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" dhe te Ligjit Nr. 7667, date 28.03.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen kryer ne te" kerkojme nga ana e gjykates tuaj rregjistrimin e kesaj shoqerie si person juridik.

Bashkengjitur kesaj kerkese jane:

1. Akti i themelimit
2. Statuti i shoqerise

Kerkuesi

Eli KANANI



19.11.1992
10.12.1996

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE DHE AMBJENTIT
Komisioni i dhenies se licencave profesionale



REPUBLIKA E SHQIPERISE
 SHENDETESISE DHE AMBJENTIT
 N. REP. 13031 TIRANE
 05.12.1996

VERETOHET NIESIA ME ORIGJINALIN
 NOTERE
 MIRANDA XHIMALÇE

L I C E N C E

Nr. 52. Date 14.08.1996

Z. ELI KANANI

Banues ne	Tirane	Diplomuar me	1960	Fakulteti i Mjekesise
Me profesion	Farmacist	Specialiteti	Farmacii	

Ne baze Ligjit Nr. 7815 date 20.4.1994 " Per barnat " dhe te Udhezimit Nr. 136 date 14.06.1996,
 " Per Licencimin e Aktivitetit Privat te Punonjesve te Shendetesise " .

I jepet licenca per te ushtruar profesionin e Farmacistit. (Per depo me shumice)

.....

Licenca eshte e vlefshme per nje periudhe 3 (tre) vjeçare .
 Vertetohet marja e licences dhe njohja me ligjet ne fuqi .

SEKRETARI

Afroviti

AFROVITI NEPRAVISHTA

I LIÇENCUARI

Eli Kanani

ELI KANANI

KRYETARI

Zamira Sinoimeri

Dr. ZAMIRA SINOIMERI



REPUBLICA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR 13092 REP


NR 14545 KOL

VERTETIM

Ne Tirane, sot me daten 05.12.1996 para meje noteres publike Miranda Xhemalce, u paraqit personalisht *BL. KAHNAN*, madhor, me zotesi te plate juridike dhe per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga letrnjoftimi, i cili deklaroi se s a siper eshte hartuar jashte kesaj zyre dhe nenshkruar ne prezence te noterit. Une noterja e vertetoi sipa ligjit.

No tere

MIRANDA XHEMALCE
NOTERE
TEL 282 84
TIRANE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR 13034 REP
NR KOL

VERTETIM

Ne Tirane, sot me daten 05.12.1996 para meje noteres publike Miranda Xhemalce, u paraqit personalisht ELI KANANI, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga letrnjoftimi, i cili deklaroi se s a siper eshte hartuar jashte kesaj zyre dhe nenshkruar ne prezence te noterit. Une noterja e vertetoj sipa ligjit.

No tere
MIRANDA XHEMALCE
NOTERE
TEL 262 84
TIRANE





REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR 13035 REP
NR 1454 KOL

VERTETIM

Ne Tirane, sot me daten 05. 12. 1996 para meje noteres publike Miranda Xhemalce, u paraqit personalisht BY KANAN, madhor, me zotesi te plote deklaroi se s a siper eshte hartuar jashte kesaj zyre dhe nenshkruar ne prezence te noterit. Une noterja e vertetoj sipa ligjit.

Notere

MIRANDA XHEMALCE
NOTERE
TEL 262 84
TIRANE



3. E. Bege
25.01.2007
25 GEN. 2007
[Signature]



K E R K E S E

KERKUESIA : **ELI KANANI**, e bija e Kostaqit, e dtl.15.06.1937, me banim ne Tirane, Rruga " Tefta Tashko" Pall. 132, shk.1, ap. 36, madhor, me zotesi juridike dhe me zotesi te plote per te vepruar.

OBJEKTI : Depozitim te dokumenteve prane Regjistrin Tregtar per ndryshimet e bera per shtese objekti dhe shtese kohezgjatje te shoqerise "KANANI" SHPK

Ne deputetat Qendrore
Objekt
01 okt. 27/1/2007
31/1/2007
[Signature]

P E R P A R A

GJYKATESSE RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

Shoqeria "KANANI" Shpk eshte regjistruar si person juridik me vendim te gjykates se Rrethit Tirane Nr. 10456/ date 10.12.1996, me kapital 100.000 leke me ortak te vetem dhe administrator Znj/ Eli KANANI, me kohe zgjatje mbi 10 vjet me objekt ne fushen e - **Import-eksportit, tregtimit me shumice e pakice, te produkteve farmaceutike humane dhe veterinare, tregtimin e pajisjeve farmaceutike.**

Kerkuesia kerkon shtese te objektit te vepriptarise edhe : **"Tregtimin e aparturave elektromjekesore", dhe kohezgjatjen e aktivitetit " me kohe te pakufizuar mbi 10 vjet".**

7
1



Ne keto kushte kerkoj depozitimin te ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregetar
ne Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

KERKUESIA
ELIKANANI

El. Kanani

[Handwritten signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE


NR. 568 REP
NR. 78 KOL.

VERTETIM

Ne Tirane, sot me daten 23.01.2007, para meje noteres publike ,
MIRANDA XHEMALCE, notere e Dhomes Notereve Tirane, me seli ne rrugen “_Zhan
D’ark” u paraqit personalish

Znj. **ELI KANANI**, e bija e Kostaqit, e dtl.15.06.1937, me banim ne Tirane,
Rruga “ Tefta Tashko” Pall. 132, shk.1, ap. 36, madhor, me zotesi juridike dhe
me zotesi te plote per te vepruar, e cila deklaroi se sa siper eshte nje kerkese drejtuar
Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, per shtese objekti dhe shtese te kohezgjatjes te
shoqerise “KANANI” Shpk, dhe e nenshkrojti ne prezence te noteres. Une noterja e
vertetoj sipas ligjit.

NOTERE
MIRANDA XHEMALCE





REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "KANANI" SHPK

V E N D I M

NR 1., date 23.01.2007

I Ortakut te Vetem te Shoqerise "KANANI" SHPK.

Sot me daten 23.01. 2007, ne seline e Shoqerise "KANANI" Shpk , ortaku i kesaj shoqerie Znj. Eli Kanani, ne baze te statutit te shoqerise dhe ligjit "Per shoqerite tregtare"


V E N D O S I :

- Shtese te objektit te veprimtarise : **" Tregtimin e aparaturave elektromjekesore", dhe shtese kohezgjatjen e aktivitetit "Me kohe te pakufizuar mbi 10 vjet".**

Shoqeria nuk ben ndryshime te tjera .

Sa siper ky vendim i Ortakut te vetem te shoqerise duhet te depozitohet ne
Zyren e Regjistrimit Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

ORTAKU I VETEMI SHOQERISE "KANANI" Shpk
ELI KANANI

El' Kanani


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR. 569 REP
NR. 7/11 KOL.

VERTETIM

Ne Tirane, sot me daten 23.01.2007, para meje noteres publike ,
MIRANDA XHEMALCE,notere e Dhomes Notereve Tirane, me seli ne rrugen “_Zhan
D’ark” u paraqit personalish, Znj. **ELI KANANI**, e bija e Kostaqit, e
dtl.15.06.1937, me banim ne Tirane, Rruga “ Tefta Tashko” Pall. 132, shk.1, ap.
36, madhor, me zotesi juridike dhe me zotesi te plote per te vepruar, e cila
deklaroi se sa siper eshte vendimi i Ortakut te vetem te shoqerise “Kanani” shpk,per
shtese objekti dhe shtese te kohezgjatjes te shoqerise “KANANI” Shpk, dhe e
nenshkrojti ne prezence te noteres. Une noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE
MIRANDA XHEMALCE



NOTERE
MIRANDA XHEMALCE
TEL 363749
TIRANE